



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:276478  
Datë: 15.03.2024  
Numri i dokumentit: 05455626

E.nr.671/23

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil,** me gjyqtarin Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani duke vendosur në lëndën e përmbarimit të kreditorve V.Xh., F.R., A.Sh., S.M., M.I. dhe S.B., të cilin i përfaqëson Av. Samir Reka nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shumës në emër të shujtës ushqimore, pagës jubilarë, shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimet e procedurës, më datë: 15/03/2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbarimore në lëndën E.nr.671/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.671/23, të datës 08/05/2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve kundër debitorit Komuna Shtime-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të Pajtimit Gjyqësor: 2021:276478, të datës 05.07.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 1/09/2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,577.70 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

E.nr.671/23, më datë 15.03.2024

**GJYQTARI**  
Faton Ajvazi